



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHËTIMIT**

---

Nr.331/1 Prot

Shkodër, më 28. 07 .2021

**Lënda** : Dërgim informacioni sipas kërkesës së dërguar nga ana e juaj.

E nderuar,

Lidhur me kërkesën tuaj të dt.12.07.2021 dhe e protokolluar nga ana e jonë me nr.prot 331 dt.22.07.2021 për informacion ju sqarojmë se :

Kërkesen për informacion për vitet 2011,2012,2013, 2014 dhe 2015 duhet t'ja drejtoni Prefekturës së Qarkut Shkodër, pasi Shërbimi i MZSH-së si funksion i deleguar në vartësi të Bashkisë Shkodër është bërë që nga dt.01.01.2016, ndaj dhe ne nuk zotërojmë informacionin e kërkuar nga ana e Juaj për këtë periudhë kohore .

Sipas kërkesave tuaja dhe sipas pikave që keni kërkuar informacion ju sqarojmë si më poshtë .

1. Drejtorja e MZSH-së Bashkia Shkoder ka një personel prej 35 efektivash , nga të cilët 28 janë efektiva operacional , ndërsa 7 janë në funksione drejtuese dhe shërbime mbështetëse. Drejtorja e MZSH-së Shkodër posedon 7 mjete zjarrfikse me ujë , 1 autoskallë , një mjet furgon, 1 mjet fuoristradë . Ky numër efektivash zjarrfikse ka mbetur i pa ndryshuar si përpara se të kalojnë në vartësi të bashkisë , ashtu edhe deri më sot . Ky numër efektivash është i pamjaftueshëm, si për sipërfaqen e shtrirjes së territorit të Bashkisë Shkodër , si dhe numrit të zjarreve që bien gjatë një viti . Duhet me patjetër të zbatohet Ligji 152/2015 ku parashikon se për 1500-2000 banorë duhet 1 efektiv zjarrfikës , dhe sipas numrit të banorëve të Bashkisë Shkodër duhen të jenë të pakten 100 efektiva zjarrfikës .
2. Në lidhje me investimet ndër vite, kemi këto informacione:

Për vitet **2016-2021** janë investuar 8.813.111 lekë, e shpërndarë sipas viteve :

- **2016** - 0 lekë
- **2017** - 1.795.200 lekë
- **2018** - 4.998.000 lekë
- **2019** - 1.621.511 lekë
- **2020** - 398.400 lekë

- **2021** – 0 lekë

Shpërndarja e këtyre investimeve për vitet **2016-2021** sipas zërave është :

- **2017** – 1.795.200 lekë blerje materiale speciale zjarrfikse , Aparate frymëmarrje AP-3
  - me vlerë 1.190.400 lekë , çizme kundra zjarri me vlerë 604.800 lekë .
- **2018** – 4.998.000 lekë blerje uniforma speciale ndërhyrjesh .
- **2019** - 261.000 lekë blerje kondicioneresh për zyrat e Institucionit ,  
-1.360.511 lekë Rikonstruksion godine.
- **2020** - 398.400 lekë blerje kompiutera e printera për institucionin .
- **2021** - 0 lekë .

3. Investimi i fundit është kryer në vitin 2020 .

4. Për vitin 2021 nuk janë planifikuar investime.

5. Buxheti i drejtorisë së MZSH-së Shkodër për vitin **2021** është 50.105.124 lekë,ndërsa për vitet e kaluara është si më poshtë:

- **2017** – 52.419.750 lekë
- **2018** - 56.382.870 lekë
- **2019** - 53.233.656 lekë
- **2020** – 50.922.675 lekë
- **2021** – 50.105.124 lekë

6. Drejtoria e MZSH-së Shkodër ka të gjitha paisjet e nevojshme për fikjen e zjarreve ( mjete me ujë dhe me shkumë , autoshkallë , pompa , pompa shpine për zjarret malore etj)

7. Me ardhjen e stinës së verës duke pasë parasyshë se Bashkia Shkodër mbulon edhe zonën e plazhit të Velipojë bën ngritjen e një stacioni provizor në plazhin e Velipojës që funksionon 24 orë pa ndërprerje nga dt.15.06.2021 deri me dt.15.09.2021 dhe mbulohet nga efektivat e gatshëm sipas planit të masave të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë , në këtë plan masash përcaktohen edhe masat e tjera bashkpunuese me Drejtoritë në vartësi të Bashkisë si dhe me institucione të tjera si Agjensia e Zonave të Mbrojtura , Inspektoriatin Pyjorë , Drejtorinë e Policisë etj .

DREJTORI I MZSH-së

Agron DIBRA